

## NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE PËR EKSPERT TË LARTË JO-KYÇ

**Projekti i financuar nga BE-ja "Asistencë Teknike për përmirësimin e mjedisit të favorshëm për Organizatat e Shoqërisë Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut"**  
**Numri i identifikimit: EuropeAid/140131/DH/SER/MK**

Projekti i financuar nga BE-ja "Asistencë teknike për përmirësimin e mjedisit të favorshëm për Organizatat e Shoqërisë Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut" është në kërkim të një Eksperti të Lartë jo-kyç me përvojë për mbështetjen e zbatimit të projektit. Projekti synon të mbështesë Qeverinë në mundësimin e mjedisit për shoqërinë civile në të njëjtën kohë të ofrojë mbështetje për organizatat e vogla dhe bazë në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive të tyre operacionale të qëndrueshme.

Projekti zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga Corporate & Public Management Consulting International (CPM)) përmes dy komponentëve: Komponenti 1) Mbështetja e zbatimit të objektivave kryesore nga Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2018-2020) – Prioriteti I , dhe Komponenti 2) fokusim në zbatimin e mbështetjes së drejtpërdrejt jomateriale përmes Mekanizmit të Qëndrueshmërisë Civile (CRM) të përshtatur për nevojat e shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Programi MQC ofron mbështetje të drejtpërdrejtë fleksibile, transparente dhe me mundësi për akses për punën e bazuar në të drejtat dhe përfitimet publike të realizuara nga organizatat e shoqërisë civile.

### **EKSPERT I LARTË JO-KYÇ - KOORDINATOR PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE**

**Inputet:** Deri në 50 ditë pune midis nëntorit 2023 dhe marsit 2024 (një pozicion)

#### **Kualifikime dhe aftësi:**

- Diplomë universitare në drejtësi, administratë publike, shkenca politike, shkenca sociale, ekonomi ose çdo fushë që ka lidhje me detyrën;
- Aftësi të mira kompjuterike (komandë e Microsoft Office);
- Njohja e shkëlqyer e gjuhës angleze të shkruar dhe të folur, njohja e gjuhës/gjuhëve lokale është një avantazh;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe ndërpersonale;
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar dhe analitike.

#### **Përvojë e përgjithshme profesionale:**

- Së paku shtatë (7) vite përvojë pune në fusha të tilla si shoqëria civile dhe/ose të drejtat e njeriut, dhe/ose demokracia, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit.

#### **Përvojë specifike profesionale:**

- Së paku pesë (5) vite përvojë në koordinimin e përmasave për ngritjen e kapaciteteve;
- Së paku tre (3) vite përvojë në dizajnimin dhe zhvillimin e trajnimeve për forcimin e kapaciteteve të organizatave;
- Përvojë e demonstruar në punën me shoqërinë civile/ lidhur me ritjen e funksioneve të shoqërisë civile dhe ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve.

**Përgjegjësitë:** Të ofrojë mbështetje për ekipin e projektit AT në zbatimin e programit të ngritjes së kapaciteteve, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: zhvillimin e mëtejshëm të programit të trajnimit (ndërtimit të kapaciteteve); të përgatisë materialet e trajnimit dhe të ofrojë trajnime, të koordinojë me trajnerë të tjerë të përzgjedhur në përgatitjen e materialeve të trajnimit dhe ofrimin e trajnimeve; përgatitja e raportit(eve) për të gjitha trajnimet dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve të kryera.

#### **APLIKIMI**

Kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret e mësipërme, duhet të dorëzojnë një CV të formatit BE në gjuhën angleze në [recruitment@cpmconsulting.eu](mailto:recruitment@cpmconsulting.eu) dhe [kepuska@cpmconsulting.eu](mailto:kepuska@cpmconsulting.eu) deri më **1 nëntor 2023 në orën 16:00 CET**. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtë do të kontaktohen me e-mail. Aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

